

## Abstrakt

Dënimet alternative janë sanksione me të cilat mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe gjithashtu mund të ndikojnë në rehabilitimin dhe risocializimin e kryesve të veprave penale. Qëllimi i dënimeve alternative është që t'iu mundësojë kryesve të veprave penale që të mos jenë të izoluar përkatësisht të burgosur, pasi që këto dënime ekzekutohen jashtë institucioneve korrektuese, por t'iu mundësojë atyre që të qëndrojnë në shoqëri në mënyrë të monitoruar. Për shkak të efekteve pozitive që kanë këto masa në luftimin e kriminalitetit, janë bërë pjesë e akteve ndërkombëtare si dhe legjislacioneve nacionale.

Duke u nisur nga rëndësia që kanë dënimet alternative, qëllimi i këtij punimi është që të analizoj adresimin e këtyre dënimeve sipas legjislacionit kosovar dhe zbatimin e tyre në praktikë, përkatësisht në praktikën e Gjykatës Themelore në Prizren. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se Kosova i ka adresuar dënimet alternative përmes Kodit Penal duke i përcaktuar edhe llojet e këtyre dënimeve siç janë; dënimi me kusht, krahas dënimit me kusht mund të shqiptohet edhe urdhri për trajtim të detyrueshëm rehabilitues dhe urdhri për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, gjysmëliria dhe urdhri për punë në dobi të përgjithshme. Poashtu edhe zbatimi në praktikë i këtyre dënimeve, është mjaftë i pranishëm. Sipas rezultateve të hulumtimit kemi ardhë në përfundim se në Gjykatën Themelore në Prizren gjatë periudhës kohore 2018-2022, janë shqiptuar gjithsej 1.923 dënime alternative, prej tyre 92,1% ishin kryes të cilët i takonin gjinisë mashkullore, ndërsa numri më i madh i kryesve i takonin grupmoshës 30-45 vjeç apo 39.0%. Në kuadër të rezultateve të këtij hulumtimi përfshihen edhe llojet e veprave penale për të cilat janë shqiptuar dënimet alternative si; lëndimi i lehtë trupor, vjedhja e shërbimeve, dhuna në familje, kanosja, rrezikimi i trafikut publik, sulmi si dhe lloje tjera të veprave penale.

*Fjalët kyçe; dënimet alternative, kuptimi, llojet, veprat penale, karakteristikat, numri i rasteve, shqiptimi etj.*

## Abstract

Alternative punishments are sanctions that can achieve the purpose of punishment and can also affect the rehabilitation and re-socialization of perpetrators of criminal offenses. The purpose of alternative sentences is to enable the perpetrators of criminal offenses not to be isolated or imprisoned, since these sentences are executed outside correctional institutions, but to enable them to remain in society in a monitored manner. Due to the positive effects that these measures have in the fight against criminality, they have become part of international acts as well as national legislations.

Based on the importance of alternative punishments, the purpose of this paper is to analyze the addressing of these punishments according to Kosovar legislation and their implementation in practice, namely in the practice of the Basic Court in Prizren. The results of the research show that Kosovo has addressed alternative punishments through the Criminal Code by defining the types of these punishments such as; conditional sentence, in addition to the conditional sentence, the order for mandatory rehabilitation treatment and the order for supervision by the probation service, semi-freedom and the order for work for general benefit can also be imposed. Also, the practical implementation of these punishments is quite present. According to the results of the research, we came to the conclusion that in the Basic Court in Prizren during the time period 2018-2022, a total of 1,923 alternative sentences were pronounced, of which 92.1% were perpetrators who belonged to the male gender, while the largest number of perpetrators belonged to the age group of 30-45 years or 39.0%. In the framework of the results of this research, the types of criminal offenses for which alternative punishments have been imposed are also included, such as; minor bodily injury, theft of services, domestic violence, threats, endangering public traffic, assault and other types of criminal offenses.

*Key words; alternative punishments, meaning, types, criminal offenses, characteristics, number of cases, pronounciation, etc.*